

NARRATIVAT LGBTQ+ NË KOSOVË:

Ndërmjet Heshtjes,
Rezistencës dhe
Riformulimit

ANITA NIKAJ

“Ma herët nuk kanë ekzistuar këta gejat, por pas lufte i kanë sjellë ndërkombëtarët.”

Kjo është një fjali që përmbledh një paragjykim mjaft të përhapur në shoqërinë kosovare. Është një narrative që pëshpëritet gjithandej, e shpërfaqur edhe në domenin publik, duke shprehur forcën e kësaj narrative të gdhendur nga patriarkaliteti e homofobia. Por, është edhe reaksion kundër diçkaje që ka ndodhur paraprakisht: forcimi i narrativave alternative LGBTQ+.

Psikologët Mc Lean dhe Syed i definojnë këto narrativa kulturore si tregime të përbashkëta që ndihmojnë njerëzit të vendosin përvojat e tyre në kontekst.

Historia e shoqërisë kosovare – e ndikuar nga periudha të ndryshme të represionit etnik dhe më pas luftës – ka krijuar një imazh të ngurtë për identitetin dhe jetën e atyre që dalin jashtë normave shoqërore. Ka një rëndësi të pamatshme, represioni etnik, për të kuptuar historinë tonë homofobe dhe fuqinë e homofobisë së sotme. Ky represion ka krijuar nevojën e natyrshme që në gjirin shoqëror të forcohej identiteti dhe solidariteti etnik, me theks të veçantë te ato që merreshin si norma kulturore shqiptare. Për dekada me radhë, ata që guxuan të sfidonin këto norma, pa të drejtë u konsiduan si “tjetri/tjerët” që përjashtohej e stigmatizohej në kuadër të luftës për çlirim. Kjo ka kontribuar që, për dekada me radhë, ‘gejtë’ të ishin aq të heshtur sa përnjëmend nuk ekzistonin për shumicën dërmuese të shoqërisë.

Rrëfimet e grupeve dominuese janë më të lehta për t’u dëgjuar dhe shpërndarë sesa narrativat e rezistencës apo ato të grupeve të përjashtuara. Në kontrast, narrativat alternative sfidojnë dhe dekonstruktojnë narrativat kryesore, duke ofruar mënyra alternative për të kuptuar përvojën dhe për të artikuluar zërat e atyre që shpesh mbeten të heshtur. Kultura homoseksuale ishte dija e shtypur (subjugated knowledge) e cila doli në dritë si e tillë vetëm pas lufte, në kushte të çlirimit nga represioni etnik

Për të kuptuar përvojat e tyre individuale, njerëzit mbështeten në narrativat dominante, pasi ato shërbejnë si një plan i përgjithshëm për të gjitha tregimet dhe bëhen mjeti përmes të cilit ata kuptojnë tregimet e tyre dhe ato të të tjerëve. Narrativat fillojnë të ndryshojnë kur njerëzit guxojnë të flasin dhe të tregojnë përvojat e veta.

Natyrisht, është banale thjesht të hedhim dyshim në ekzistencën e pakicave seksuale në Kosovë në periudhën e mëparshme. Mirëpo, është e udhës që këto paragjykime homofobe të sfidohen qysh në banalitetet më elementare të tyre.

Formulimi i mësipërm më del përpara vazhdimisht përgjatë diskutimeve për komunitetet LGBTQ+ me familjarë, shokë e shoqe, profesorë, mësues dhe të panjohur. Është një formulim që mban të fshehtë ‘formulën’ jo thjesht për mohimin e ekzistencës së komuniteteve LGBTQ+, por edhe për ta sulmuar ekzistencën e këtij grupi në ditët e sotme. Pra, në paraqitjen e kësaj ekzistence si diçka joautentike, false, që na erdhi në mesin tonë në mënyrë të imponuar gjatë viteve të lirisë nga prania ndërkombëtare në Kosovë.

Para luftës, komunitetet kanë funksionuar si një trup homogjen, ku ata që kanë guxuar të flasin e veprojnë lirshëm ishin të paktë e të pakta. Grupet ishin të vogla, me persona që kryesisht njihnin njëri-tjetrin. Kështu tregojnë Qerkica, një grua transgjjinore ashkallike, dhe Mustafa, një gej shqiptar, në rrëfimin e tyre për Dylberizmin.

“I thojsha unë ni personit hajde te unë në party, thirre shokin tond, ai shokin e vet, ky shokin e vet...”

Me kalimin e kohës, homogjeniteti në fjalë është përmbysur. Dalja haptas e një grupi në rrugë, rrjetet sociale, dalja publike nëpër televizione e radio, e kanë ndryshuar dhe zgjeruar narracionin e komuniteteve LGBTQ+ si duke thënë “ne ishim gjithnjë këtu”.

Të tjerë kanë tentuar që përmes nxjerrjes në pah të rasteve të pakta të dokumentuara sic është poezia e Andon Zako Cajupit, të argumentojnë këtë prezencë.

E megjithatë, kjo ka hasur në vështirësi tjera.

Narrativa që nxiti reaksion

Narrativat e forta nacionaliste e fetare dominojnë në Kosovë ndaj çdo narracioni tjetër marginal. Rrjedhimisht, kjo e vështirëson komunikimin në mes kulturës së përhapur homofobike në Kosovë dhe komuniteteve LGBTQ+.

Përderisa grupe fetare, politike, fashiste dhe nacionaliste vazhdimisht kanë ushtruar urrejtje ndaj komuniteteve LGBTQ+ në Kosovë, duke i targetuar në mënyra dhe forma të poshtërueshme, figura si Duda Balje, deputete në Kuvendin e Kosovës, Labinota Demaj-Murtezi, deputete e Lëvizjes Vetëvendosje, dhe ish-deputeti Eman Rrahmani kanë dalë hapur kundër këtyre komuniteteve. Rrahmani, madje, ka shkuar një hap më tej, duke krijuar një parti të quajtur "Koalicioni Për Familjen", e cila gjatë gjithë fushatës së saj ka pasur si qëllim kryesor denigrimin e personave queer.

Labinota Demaj-Murtezi, duke shfrytëzuar pozitën e saj si deputete në një seancë publike më 16 mars 2022, deklaroi se personat e komunitetit LGBTQ+ “bartin sëmundje”. Kjo narrativë shtypëse është riprodhuar vazhdimisht nga aktorë homofobë, të cilët shpesh e mbështesin diskursin e tyre në religjion.

Në kushte të lirisë e vërteta mund të dalë në pah edhe nga narracionet alternative të grupeve më të vogla. Dhe kjo përgjithësisht ndodhi në vendin tonë.

Komunitetet LGBTQ+ kanë jetuar për dhjetëra e dhjetëra vite nën hije dhe padukshmëri, si pjesë e heshtur dhe e shpërfillshme e familjeve, shkollave, rrugëve të qyteteve e fshatrave. Por, kjo padukshmëri e shpërfillje vetëm sa e ka rritur zërin e saj kur u krijuan mundësitë që të kishte një shprehje sadopak të lirë. Ajo është një histori e rezistencës komunitare që ia doli të ndërtonte hapësira të sigurt, të protestonte e të ngriste zërin ndaj padrejtësive. Por, derisa kjo ka rritur ndërgjegjësimin për lirinë dhe të drejtat e njeriut, ka nxitur njëkohshëm një reagim të çuditshëm që shprehet përmes kundërnarrativave negative e urrejtëse ndaj LGBTQ+ në Kosovë.

Blert Morina, drejtor ekzekutiv i CEL Kosova, njashtu dhe personi i parë transgjinnor në Kosovë që ka ndërruar emrin ligjërisht, deklaroi se narrativat negative të cilat për shumë vite janë shpërndarë në ajër ndikojnë negativisht në shëndetin psikologjik.

“Narrativat negative publike dhe stereotipet mbi personat LGBTQ+ kanë ndikim të madh në shëndetin psikologjik të tyre, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në mirëqenien emocionale dhe sociale. Këto narrativa përforcojnë stigmatizimin dhe diskriminimin, çka çon në ndjenja të izolimit, turpit dhe vetë-mohimit. Si rezultat, shumë individë LGBTQ+ përjetojnë nivele të larta stresi, ankthi dhe depresioni”.

Këtë gjë e vërteton edhe hulumtimi i CEL Kosova, në vitin 2024, ku ankthi tek pjesëtarët e komuniteteve LGBTQ+ është sfida më e përhapur e shëndetit mendor, e pasuar nga frika, vetmia, depresioni, pasiguria.

Ndër të tjera, një hulumtim i vitit 2015 i kryer nga Instituti Kombëtar për Demokraci (NDI), tregon se 81% e personave LGBTQ+ në Kosovë kishin raportuar se kanë përjetuar ngacmime verbale ose abuzim psikologjik, ndërsa 29% kanë raportuar dhunë fizike, duke shënuar një nga përqindjet më të larta të dhunës në Ballkanin Perëndimor.

Ndërsa në vitin 2022, në një hulumtim të bërë nga poashtu CEL Kosova, 38% e pjesëmarrësve në anketim kanë tentuar të vetëvriten, 80% e tyre kanë përjetuar ankth, 49% e tyre vuajnë nga depresioni, ndërsa 31% e tyre nga stresi.

Për Morinën, stereotipet janë shumë problematike.

“Përveç ndikimit emocional, këto stereotipe krijojnë barriera për qasjen në kujdesin shëndetësor dhe mbështetjen sociale. Frika nga paragjykimi, përjashtimi apo trajtimi jo i barabartë bën që shumë persona LGBTQ+ të shmangin ndihmën profesionale për shëndetin mendor. Kjo situatë përkeqësohet sidomos tek të rinjtë, të cilët gjatë fazës së zhvillimit të identitetit të tyre seksual apo gjinor përballen me presione të mëdha sociale dhe familjare. Në mungesë të një mjedisi të sigurt dhe mbështetës, mirëqenia e tyre emocionale rrezikohet ndjeshëm, duke thelluar pasojat psikologjike të paragjykimeve shoqërore.”

Dhuna dhe paragjykimet ndaj personave të komuniteteve LGBTQ+ ishin gjithnjë mes nesh si mjete shoqërore disiplinuese. Por, është po ashtu e vërejtshme se krahëpërkrahë ndërgjegjësimit për të drejtat dhe liritë që i takojnë komuniteteve kemi edhe një reagim gjithnjë e më të fortë publik që del zëshëm kundër duke i dhënë më shumë legjitimitet shtypjeve homofobike.

Edhe më tej personat e komuniteteve rrallë dalin publikisht për të treguar orientimin e tyre seksual. Stigma në fjalë është rforcuar.

Në rastet kur kemi parë daljen publike, kemi parë edhe forcën e pabesueshme të reagimit nga ana tjetër, për të cilin po bëjmë fjalë.

Thyerja e reaksionit

Edona James, një grua transgjinore që nuk jeton në Kosovë e ka përjetuar deri në palcë transfobinë. Edhe pse kanë kaluar vite të tëra që nga dalja publike e saj, ajo vazhdon të përballlet me komente ofenduese e kërcënuese.

Edoni, i cili kishtë vendosur që të kandidonte si një “Drag Queen” në një reality shoë si “Big Brother” po ashtu ishte përballur me komente homofobike.

Ndërsa vitin e kaluar, gazetari Vullnet Krasniqi, po në të njëjtin reality shoë, për herë të parë doli publikisht dhe tregoi orientimin e tij seksual.

Për Vullnetin, të dalurit hapur është përcjellur nga presioni i jetës publike të cilën ai e ka bërë më herët. Sipas tij, është e rëndësishme që sa më shumë persona të dalin hapur për ta neutralizuar sa më shumë reagimin shoqëror.

“Sa më shumë persona që bëjnë jetë publike, që ndiqen nga njerëzit apo që merren si model – në rastin tim, ata që më besojnë si gazetar – aq më e rëndësishme është të jetoj hapur si gej. Kjo, sepse duhet të normalizohet fakti që gejët, lezbiket dhe personat queer janë kudo. Ata nuk janë të margjinalizuar. Mund të jesh mjek i njohur dhe gej, deputete dhe lezbike, artiste, sportist, apo kushdo tjetër – dhe njëkohësisht queer. Natyrisht, ky lloj presioni për të jetuar hapur nuk u takon atyre që nuk bëjnë jetë publike. Për ta, kjo është dhe duhet të mbetet një zgjedhje personale.”

Disa stereotipe, sipas tij, duhet të diskutohen më tepër se tjerat, sado që të gjitha dëmtojnë.

“Narrativat që dua t’i sfidoj janë pikërisht ato stereotipe që pretendojnë se personat LGBTQ+ janë të pranishëm vetëm në disa profesione të caktuara, që duken në një formë të caktuar apo që bëjnë vetëm gjëra të caktuara. E vërteta është se nuk ka asnjë profesion, asnjë pamje, asnjë mënyrë sjelljeje që e përcakton një person LGBTQ+. Ne jemi kudo — në çdo fushë, në çdo rol, në çdo formë. Prandaj, është e rëndësishme që të flasim dhe dalim hapur.”

Sipas hulumtimit të CEL Kosovës, një pjesë e madhe e personave të komuniteteve LGBTQ+ ndihen të vetmuar, kjo si pasojë e asaj se njohin shumë pak persona tjerë, ose fare. Kjo i bën ata që të besojnë se janë të vetmit në Kosovë.. Prandaj, sipas pjesëtarëve të komuniteteve, është shumë e rëndësishme që të flasin sa më shumë mes vete, t’i rikrijnë narrativat apo edhe të krijojnë narrativa të reja.

“Është shumë e rëndësishme të flasim me njëri-tjetrin – por, fatkeqësisht, kjo ndodh shumë pak në Kosovë. Eksperiencat tona janë shpesh të ngjashme, dhe mund të na ndihmojnë shumë për t’i përballuar disa situata që, nëse nuk flet me askënd, të duken sikur po të ndodhin vetëm ty. Të ndash përvojën, ndonjëherë edhe vetëm duke dëgjuar tjetrin, është një formë mbështetjeje që mund ta bëjë dallimin mes ndjenjës së vetmisë dhe ndjenjës së përfshirjes.” - tregon Krasniqi.

Vetë gjuha mund të jetë performative, duke mishëruar rezistencë vetëm përmes të shprehurit

Rezistencën të cilën e kanë ndërtuar komunitetet LGBTQ+ ndër vite është përkthyer me “Paradën e Krenarisë”. Çdo vit, Parada e Krenarisë bart një temë si: “Në Emër të Lirisë” (2017), “Në Emër të Dashurisë” (2019), “Së Bashku dhe Krenarë” (2021), pjesë e Javës së Krenarisë.

Në vetvete, si të tilla, këto thirrje funksionojnë si kundër-narrativa ndaj diskursit dominues të heshtjes, turpimit dhe refuzimit. Gjatë Paradës, personat e komuniteteve LGBTQ+ dhe aleatët e kanë rastin të ecin në rrugët e kryeqytetit, duke treguar historinë e tyre përmes pankartave, fjalimeve dhe artit. Në të njëjtën kohë, ky marshim shërben edhe si një lloj proteste kundër homofobisë, transfobisë, bifobisë. Kjo tregimësi publike e shndërron cenueshmërinë në rezistencë kolektive, duke riformuluar ekzistencën queer si diçka thellësisht njerëzore.

Roli i organizatave dhe rrëfimet si mjet kundërshtimi

Organizatat jo-qeveritare si CEL Kosova (Centre for Equality and Liberty), CSGD (Center for Social Group Development), përdorin histori personale të pjesëtarëve të komuniteteve në media, në ngjarjet e Paradës së Krenarisë, dhe zhvillojnë kampanja për të kundërshtuar heshtjen shoqërore. Duke shfaqur përvojat e marginalizimit, refuzimit familjar dhe qëndrueshmërisë, këto narrativa i riformulojnë komunitetet LGBTQ+ si pjesë integrale të shoqërisë kosovare, duke çmontuar stereotipin e identitetit queer si “të huaj”.

Gjersa deputetët shfrytëzojnë hapësirat e Kuvendit të Kosovës për të përhapur gjuhë homofobike, organizatat kanë shumë pak mundësi për të ndikuar në censurimin apo ndëshkimin e këtyre personave, pasi fuqia që ata bartin është dukshëm më e madhe. Aksionet që zhvillohen ndaj tyre zakonisht ndërmerren përmes rrugëve ligjore ose duke penguar punën e tyre. Kjo për faktin se komentet e zonjës Balje dhe të Demaj-Murtezi shpesh shtyhen nga diskursi fetar.

Përkundër përballjeve të drejtpërdrejta me këta aktorë, komuniteti përballet me sfida edhe më të thella. Kur përballë gjenden të mitur që kanë përjetuar dhunë fizike dhe psikologjike nga familjarët e tyre, organizatat shpesh mbeten në një udhëkryq, pasi ligji nuk është në anën e tyre për të ofruar strehim dhe siguri.

“...Një ndër sfidat më të mëdha ka qenë trajtimi i rasteve që përfshijnë të miturit. Këto raste jo vetëm që janë më të ndjeshme për shkak të ndërhyrje moshës, por shpesh kërkojnë të menjëhershme, për shkak të rrezikut të lartë në të cilin ndodhen. Mungesa e një strehimoreje të dedikuar në vend për këtë grup e ka bërë situatën edhe më të ndërlikuar, duke e bërë të domosdoshme, në disa raste, zhvendosjen e tyre në Shqipëri, ky një proces i vështirë logjistikisht dhe emocionalisht.

Shumica e këtyre të miturve kanë jetuar në ambiente abuzive, duke përjetuar forma të ndryshme dhune fizike dhe psikologjike. Kjo e bën të domosdoshme një qasje gjithëpërfshirëse, që përveç mbrojtjes së menjëhershme, përfshin edhe mbështetje të vazhdueshme për rehabilitim dhe integrim.” – tregoj Morina.

Narrativat e komunitetit LGBTQ+ në Kosovë janë një dëshmi e guximit përballë heshtjes së trashëguar. Në këtë rrugëtim të gjatë, tregimi i çdo individi bëhet një fije e rëndësishme në thurjen e një të ardhmeje më të mirë dhe të hapur, ku çdo zë mund të dëgjohet dhe pranohet pa frikë.

Ky tekst mbështetet nga Ambasada e Holandës në Kosovë. Përmbajtja e këtij teksti nuk pasqyron qëndrimet e Ambasadës së Holandës në Kosovë.